

Takim dy ditor në Prishtinë, nën mikëpritjen e homologëve të Zyrës së Rregullatorit për Energjinë ZRRE

Në datat 27 dhe 28 dhjetor, Enti Rregullator i Energjisë, ERE, u mirëprit nga homologët e Kosovës, ZRRE/ERO. Gjatë këtyre dy ditëve, u zhvillua një mbledhje e përbashkët me ZRRE ku palët pjesmarrëse shqyrtuan, diskutuan dhe miratuan kuadrin rregullator që do t'i shërbejë operimit të Bursës së Energjisë, ALPEX, si dhe bashkimit të tregut të energjisë elektrike.

Kryetarët e Rregullatorëve të Shqipërisë dhe Kosovës, Z. Ahmeti dhe Z. Fejzullahu gjatë fjalës së tyre falenderuan palët pjesmarrëse dhe theksuan rëndësinë e këtij procesi jo vetëm për Shqipërinë dhe Kosovën, por dhe për rajonin. ALPEX pritet të fillojë me operimin e tregut të ditës në avancë në Shqipëri, dhe më pas, brenda një periudhë dy mujore do të operojë me tregun e bashkuar të dy vendeve, për një periudhë të shkurtër në kushtet e Dry Run, për të vijuar më tej me operim të plotë.

Në datën 28 dhjetor, Bordit i komisionerëve të ERE-s, zhvilloi mbledhjen e radhës në të cilën u morën vendime për çështje që lidhen ushtrimin e autoritetit rregullator të ERE, e konkretisht mbi:

1. Shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së shoqërisë Hec - Arsti sh.p.k., për zgjatje të afatit të derogimit për një periudhë prej 24 muajsh, duke vendosur për shoqërinë detyrimin e informimit periodik të ERE çdo 6 muaj mbi ecurinë e plotësimit të traktit 110 kV me të gjithë elementet e nevojshëm përfshirë dhe integrimin në sistemin SCADA.
2. Licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
3. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “KESH sh.a në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës i përbërë nga dy gjenerues Tigri 1 dhe Tigri 3, për një afat 2-vjeçar. Ky TEC parashikohet të ketë një fuqi të instaluar 110-130 MW.

4. Mos fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së HEC-in Shkopet, për të cilën shoqëria “Kurum International” sh.a., ka paraqitur kërkesë për rritje të kapacitetit prodhues.
5. Pranimin e kërkesës së shoqërisë Albgaz sh.a. për shtyrjen e afateve të kushteve të vendosura ndaj Albgaz në kuadër të certifikimit si “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” referuar Vendimit të Bordit nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar.
6. Në kuadër të kësaj vendimarrje u konstua se sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179/2017, i ndryshuar, që lidhet me paraqitjen në ERE çdo vit ushtrimor të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë, shoqëria Albgaz sh.a. ka paraqitur dokumentacionin respektiv dhe si i tillë ky kusht konsiderohet i plotësuar/përditësuar për vitin 2021 dhe pika 5.1 e këtij vendimi mbetet e pandryshuar. Po ashtu një tjetër kusht që lidhet me certifikimin e këtij subjekti është edhe bashkëpunimi ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46 (10), i Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë. Konstatohet se shoqëria Albgaz sh.a. ka bërë hapa në plotësimin e këtij e do të ndërmarrë me tej hapat e nevojshëm për të adresuar pranë MIE-s gjetjen e një zgjidhjeje të gjithëpranuar brenda kuadrit ligjor. Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se po hedh hapa konkretë drejt një partneriteti të mundshëm me shoqëri të huaja (MoU me ENAGAS), të cilat kanë një përvojë të gjerë në sektorin e gazit natyror, çka do të sjellë dhe rikonfigurimin e përfaqësimit të kapitalit të shoqërisë. Në këto rrethana, u pranua, kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri në datën 20.11.2023, duke vendosur shtyrjen e afatit deri në datën 20.11.2023. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 21.11.2022.
7. Një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sha në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar, për shtyrjen e afatit të depozitimit në Certifikatën e Sigurimit në ERE brenda datës 30.04.2023, kusht i domosdoshëm për tu plotësuar nga shoqëriasa cituar dhe në vendimet e mësipër përmendura. Këto vendime i shtrijnë efektet duke filluar nga data 21.12.2022.
8. Miratimin paraprak Zyrtar të Përputhshmërisë së “ALBGAZ” sha me kushtin që brenda 30 ditëve nga ky miratim, shoqëria “ALBGAZ” sha të depozitojë në ERE vendimin e

Këshillit Mbikëqyrës të “ALBGAZ” sha, për emërimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë, si dhe kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë të nënshkruar mes “ALBGAZ” sha dhe këtij të fundit.

Po në këtë mbledhje, u diskutuan informacione të përgatitura mbi:

- ✓ Raportin vjetor të përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror nga “ALBGAZ” sh.a., për vitin 2021. Ky raport hartohet nga Zyrtari i përputhshmërisë në mbështetje të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror“, i ndryshuar, në zbatim të kërkesave të nenit 73 dhe 74 të “Programit të Përputhshmërisë“, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 77, datë 26.05.2017, “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror“, si dhe si kërkesë e detyrave të lëna në vendimin e bordit të ERE-s Nr. 78, datë 26.05.2017, “Mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror“, Zyrtari i Përputhshmërisë së ALBGAZ sha, ka dërguar Raportin Vjetor të Përputhshmërisë për AlbgaZ sh.a. (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror), për periudhën 01.01.2021-18.11.2021. Zyrtari ka konstatuar se për periudhën 01.01.2021-18.11.2021, ALBGAZ sha është në përputhje me standardet e industrisë, Ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2021 e ka analizuar kompaninë sipas Programit dhe ushtruar detyrën e tij që programi të zbatohet nga shoqëria. Gjithashtu, përgjatë 2021, Zyrtari është kujdesur që kompania të respektojë dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari, së bashku me ALBGAZ sha kanë bashkëpunuar për të krijuar rregullore, udhëzime, trajnime, prezantime dhe procese aktive në mënyrë që kompania dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshme me programin. Disa nga konkluzionet në këtë raport konsistojnë në:

Kushtet ku ndodhet tregu i gazit në vend, zhvillimi i aktivitetit të ALBGAZ sha dhe zhvillimi i tregut të gazit është një proces i rendë, si në volume projektimi dhe financimi. Kërkohen gjithashtu dhe burime njerëzore të mëdha dhe të kushtueshme, së bashku me shtrirje kohore të zgjeruara. Por për të arritur këto rezultate në mënyrë graduale, duhet që ALBGAZ sha të:

- Krijojë kushte për përfitim të investimeve të huaja direkte në këtë segment të industrisë;
- Rritjen e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impact prej sektorit të gazit.
- Përmirësimin e furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;

- Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kostosh energjitike në nivel prodhimi mallrash dhe shërbimesh
- Ulje në përgjithësi e faturës energjitike të konsumatorit familjar fundor
- Krijimin e kapaciteteve njerëzore në vend në drejtim të paraprosjektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve, duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

Raportin e pajtueshmërisë së OST sh.a

✓ Me vendimin e ERE-s Nr. 43, datë 15.03.2017 është miratuar *çertifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 9 pika 6 të “Direktivës 2009/72/EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në bazë të detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë, i miratuar me vendim të Bordit të ERE-s, nr.103, datë 30.04.2018 “Për miratimin e programit të pajtueshmërisë të OST sh.a.” është hartuar Raportin e pajtueshmërisë së OST sh.a., për vitin 2021, nga Zyrtari i Pajtueshmërisë së shoqërisë, nga analiza e të cilit ERE konstatoi që OST ka bërë një punë të mirë në drejtim të zbatimit të parashikimeve të vendimit të çertifikimit por mbetet për tu fokusuar në zbatimin e programit të pajtueshmërisë dhe implementimit të rekomandimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë lidhur me :*

- hartimin dhe përgatitjen e një programi trajnues nga Sektori i Politikave të Sigurisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve TI dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Automatizuara të Rrjetit, i cili të përmbaje tema të veçanta dhe të personalizuar sipas platformave në menaxhim dhe punonjësve që do të trajnohen.

- OST të bëjë rishikimin e Programit të Pajtueshmërisë, duke reflektuar në të ndryshimet më të fundit ligjore, nënligjore, rregullatore si dhe ndryshimet e strukturës organizative të OST.

Monitorimin e veprimtarisë së shoqërisë FSHU sh.a,

✓ Mbështetur në Ligjin Nr.43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 20, gjerat "a" dhe "h", neneve 80-85 dhe 94 dhe 96, si dhe të Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 201/2018 "Mbi miratimin e Planit të Masave për OSHEE sh.a.,

për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit Nr. 89, datë 15.06.2022, është ushtruar Monitorimi i shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me :

- detyrimet dhe raportimet periodike si dhe mbi mbikqyrjen e zbatimit të detyrave që rrjedhin për të licencuarin nga Vendimi i Bordit të ERE-s, nr. 201/2018, i rishikuar me vendimin nr. 217/2020 "Mbi rishikimin e Planit të Masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike".

Në kuadër të këtij monitorimi ndër të tjera konstatohet:

- Niveli i zgjidhshmërisë së ankesave për periudhën Tetor 2021 - Qershor 2022 është 94 %, por duhet të merret në konsideratë që cdo ankesë e konsumatorëve të trajtohet dhe të zgjidhet sipas akteve ligjore në fuqi dhe në cdo rast FSHU sh.a. të vijojë me përmisimin e këtij treguesi për të arritur në nivelet maksimale të zgjidhjes së cdo ankese të konsumatorëve.
- Faqa e internetit të FSHU sh.a., ka të publikuara informacione dhe shërbime që u shërbejnë përdoruesve/klientëve. Lidhur me gjetjet e këtij monitorimi u la detyrë vijimi i punës për përpunimin e rekomandimeve për sa konstatuar lidhur me objektin e këtij monitorimi dhe rekomandimeve të monitorimit të ushtruar me herët ndaj FSHU sh.a.